

## B.E.K.O.J. (java 6 nga 6)

### Java 6 – Jetën me Krishtin Trego

Mirë se erdhët në festimin e kishës sonë! Si ndiheni deri tani?

#### **B.E.K.O.J.**

Jemi në pjesën e fundit të serisë BEKOJ.

*Unë do të bekoj ... dhe të gjithë njerëzit e tokës do të bekohen nëpërmjet teje. Do të bekoj që të jesh bekim. Zanafilla 12:2-3. Besojmë se ndërkohë që Perëndia na bekon, Ai do që të jemi bekim për të tjerët. Duke bërë këtë, ne natyrshëm zbulojmë misionin që Jezusi ka për jetën tonë.*

Kemi parë çdo shkronjë të fjalës BEKOJ. Sot jemi te shkronja J—Jetën me Krishtin Trego. Kur po mendoja për mesazhin sot, mu kujtua një thënie nga Fransis i Asisit: “*Prediko Ungjillin çdo herë. Nëse është e nevojshme, përdor edhe fjalë.*” A e ka dëgjuar ndonjëherë dikush këtë thënie?

Por çfarë kemi folur gjatë kësaj serie? Cili ishte akronimi i fjalës BEKOJ? Sepse e kemi parë shkronjë pas shkronje.

B. Bjer në gjunjët e lutjes. Lutu: Si të bekoj dikë sot? Çfarë mund të bëj për dikë sot?

E. E dëgjoj tjetrin. Lutu: Zot, më ndihmo të tregoj interes për sfidat, dhimbjet dhe tensionet që po kalon dikush që jeton me mua, është në shkollë me mua, ose në punë. Dëgjo komunitetet përreth—cilat janë nevojat dhe çfarë mund të bësh për një komunitet të caktuar ose për një nevojë të caktuar.

K. Konsumojmë kafe / vakte qëllimisht. Fto dikë për darkë në shtëpinë tënde, ose pi kafe me dikë qëllimisht për ta dëgjuar, për të bërë diçka për të, dhe për t’i folur për dashurinë e Perëndisë.

O. Ofroj shërbimin tim dikujt në nevojë. Lutu: Zot, çfarë mund të bëj sot për të ndihmuar dikë?

Sot do të shikojmë shkronjën e fundit të fjalës BEKOJ—J.

**J. Jetën me Krishtin Trego.** Si të tregoj historinë e jetës time, historinë që Perëndia ka bërë në jetën time.

Të tregosh të tjerëve historinë tënde kërkon guxim.

Si ishte ajo thënia nga Fransis i Asisit:

*"Prediko Ungjillin çdo herë. Nëse është e nevojshme, përdor edhe fjalë."*

Në këtë thënie, fjala kyçe është "**nëse**". Kjo sugjeron që ndoshta nuk do të jetë gjithmonë e nevojshme të përdorësh fjalë për të predikuar. Më pëlqen kjo pjesë që s' duhet të thuash fjalë, se nuk është aq e lehtë t' u flasësh të tjerëve për dashurinë e Perëndisë apo jo?! Edhe për mua, shpesh më duket më e lehtë të predikoj përpara një grupi të madh sesa të flas për Jezusin me një komshi të vetëm. Të flasësh për dashurinë e Perëndisë nuk është gjithmonë e lehtë, apo jo?

Por, fjala BEKOJ nuk është e plotë pa shkronjën e fundit. Le të shikojmë një histori nga Bibla që ilustron se si Jezusi vetë e ndau historinë e jetës së Tij me dikë.

## **Jezusi dhe Nikodemi**

*Midis farisenjve ishte një njeri me emrin Nikodem, një krer i Judenjve. Ky erdhi natën te Jezusi dhe i tha... **Gjoni 3:1***

Sfondi i historisë është i tillë: Farisenjtë ishin shumë konservatorë, shumë të edukuar dhe një grup me shumë ndikim mes hebrenjve. Ata kishin zakon të përplaseshin me Jezusin shpesh dhe e kundërshtonin vazhdimisht. Nikodemi, një farise që donte ta njohte Jezusin, erdhi gjatë natës për të shmangur vëmendjen e komshinjve. Ai i tha Jezusit:

*Ky erdhi natën te Jezusi dhe i tha: ``Mësues, ne e dimë se ti je një mësues i ardhur nga Perëndia, sepse askush nuk mund të bëjë shenjat që bën ti, në qoftë se Perëndia nuk është me të``. **Gjoni 3:2***

*Jezusi iu përgjigj dhe tha: ``Në të vërtetë, në të vërtetë po të them që nëse një nuk ka rilindur, nuk mund ta shohë mbretërinë e Perëndisë``. **Gjoni 3:3***

Dhe këtu fillon biseda. Nikodemi tha se e pranon që Jezusi kishte ardhur nga Perëndia, sepse kishte parë mrekullitë që Ai kishte bërë. Por Jezusi nuk i tha: "Tashti, është e dukshme, nuk e shikon ti, gjithë ky djalë këtu, djali i gjatë i

Malësisë, se Jezusi është lindur në veri, në Nazaret. Faleminderit, faleminderit, pas 30 minutash do të jap autografe.”

Në vend të kësaj, Ai e coi bisedën në një drejtim ndryshe dhe tha që këto gjëra ndodhin në nivele të tjera; janë gjëra që i bën Perëndia. Ato vijnë nga Ai. Dhe natyrshëm, ky farise duhej t’i dinte këto, por nuk po kuptonte fare.

*Nikodemi i tha: ``Po si mund të lindë njeriu kur është plak? A mund të hyjë ai për së dyti në barkun e nënës së vet dhe të lindë?``* **Gjoni 3:4**

A po thoshte, kjo s’ka mundësi të ndodhë. Jezusi iu përgjigj:

*Jezusi u përgjigj: ``Në të vërtetë, në të vërtetë po të them se kush nuk ka lindur nga uji dhe nga Fryma, nuk mund të hyjë në mbretërinë e Perëndisë.* **Gjoni 3:5**

Ka lindur nga uji—në fakt, çdo fëmijë kur lind kalon përmes ujit. Por për të hyrë në Mbretërinë e Perëndisë, është e nevojshme një lindje tjetër, lindja nga Fryma.

Një çift sjell në jetë një fëmijë, por ndryshimi që bën Fryma e Perëndisë në jetën tonë është Ai që na bën fëmijë të Perëndisë.

*Ç`ka lindur nga mishi është mish; por ç`ka lindur nga Fryma është frymë. Mos u mrrekullo që të thashë: "Duhet të lindni përsëri".* **Gjoni 3:6-7**

*Era fryn ku të dojë dhe ti ia dëgjon zërin, por ti nuk e di nga vjen as ku po shkon; kështu është edhe çdo njeri që ka lindur nga Fryma``*. Nikodemi, duke u përgjigjur, i tha: ``Si mund të ndodhin këto gjëra?`` **Gjoni 3:8-9**

Nikodemi u habit, sepse Jezusi po tregon për dicka të re sesi mund ta kërkoshe dhe ta gjesh Perëndinë.

*Jezusi u përgjigj dhe i tha: ``Ti je mësuesi i Izraelit dhe nuk i ditke këto gjëra? Në të vërtetë, në të vërtetë po të them se ne flasim atë që dimë dhe dëshmojmë atë që pamë, por ju nuk e pranoni dëshminë tonë.* **Gjoni 3:10-11**

*Në qoftë se ju fola për gjërat tokësore dhe ju nuk besoni, si do të më besoni nëse ju flas për gjërat qiellore? Askush nuk u ngjit në qiell, përveç atij që zbriti nga qielli, pra, Birit të njeriut që është në qiell.* **Gjoni 3:12-13**

Jezusi po thoshte: "Unë po ju flas për gjëra qiellore, sepse kam zbritur prej andej. Kështu që, përgatituni të dëgjoni gjëra që nuk i keni dëgjuar më parë."

*Dhe ashtu si Moisiu e ngriti lart gjarprin në shkretëtirë, kështu duhet të ngrihet lart Biri i njeriut, që kushdo që beson në të të mos humbasë, por të ketë jetë të përjetshme.* **Gjoni 3:14-15**

*Sepse Perëndia e deshi aq botën, sa dha Birin e tij të vetëmlindurin, që, kushdo që beson në të, të mos humbasë, por të ketë jetë të përjetshme. Gjoni 3:16*

*Sepse Perëndia nuk e dërgoi Birin e vet në botë që ta dënojë botën, por që bota të shpëtohet prej tij. Gjoni 3:17*

Kur Ai tha, “Biri i njeriut duhet të ngrihet lart,” po parashikonte sesi do të ishte vdekja e Tij; do të ngrihej lart në kryq. Dhe pastaj janë këto vargjet bomba: 15, 16, 17. Kushdo që beson në Birin e Perëndisë ka jetën e përjetshme. Kush e di Gjoni 3:16? A e themi një herë të gjithë me zë të lartë?

Ky varg quhet ndryshe zemra e Biblës dhe është shumë i përdorur, por Jezusi e tha këtë varg atë natë, duke biseduar me Nikodemin.

Shiko si ndodhi: Nikodemi tregoi interes për gjërat shpirtërore dhe Jezusi i tregoi atij se kush ishte dhe se çfarë duhet të bënte Nikodemi për të gjetur rrugën për te Perëndia. Kjo është shkronja e fundit e BEKOJ: J – jetën me Krishtin trego.

**Që të B.E.K.O.J. dikë, duhet t’i tregoj historinë e jetës time.** Cila ishte thënia që e filluam nga Fransis i Asisit, i krishteri italian që ka jetuar në shek. 12? **“Prediko Ungjillin çdo herë. Nëse është e nevojshme, përdor edhe fjalë.”**

Njëri thotë: “Po mirë, unë nuk i flas kujt për Jezusin, sepse kam vënë një peshk në makinë dhe nuk është e nevojshme; ta shikojnë vetë, ose kam vënë kryq në qafë, ose kam Bibël në zyrë. Le të predikojë pastori, se atë punë ka ai. Unë po hedh një varg Bible në social media dhe le të kuptojnë vetë nëse dëshirojnë që jam i krishterë.”

Sepse unë nuk jam dhe aq orator; ndonjëherë nuk di ç’të them, dhe Biblën nuk e kam mbaruar të gjithë, sa të më tallin, s’po flas fare më mirë. Por ajo që do të ndodhë është se, pasi ti fillon të lutesh, të dëgjosh me vëmendje, të pish kafe, të bësh diçka për dikë, natyrshëm do të vijë momenti për të thënë diçka. Edhe nëse nuk thua asgjë, do të të pyesin vetë. Pra, sa më shumë mundësi të krijohen, mos i lër të ikin kot. Sepse nuk është e plotë fjala BEKOJ pa J në fund. Për të bekuar dikë dhe për të qenë bekim, do të ketë momente kur do të duhen fjalët, do të duhet të thuash diçka.

*Bibla thotë: Si do ta thërrasin, pra, atë, të cilit nuk i besuan? Dhe si do të besojnë tek ai për të cilin nuk kanë dëgjuar? Dhe si do të dëgjojnë, kur s’ka kush predikon? Romakeve 10:14*

Kjo thënie, “Nëse është e nevojshme, përdor fjalë,” është për t’i nxitur njerëzit që sjellja e tyre të përputhet me besimin që thonë me gojë. Shpesh kemi merakun se çfarë do të thonë njerëzit. Po sikur të kishim merakun se çfarë thotë Perëndia dhe sa e rëndësishme është që dikush ta njohë Perëndinë përmes nesh?

### **Kur ndan historinë e jetës tënde, sjell shumë ndikim dhe ndryshim në jetën e dikujt.**

Ka momente kur fjalët janë të nevojshme. Fjalët zënë vend kur së pari është një shoqëri e mirë; i njeh personat, janë njerëz që i do, ose je lutur për ta, i ke dëgjuar, ke ngrënë, ke pirë kafe me ta. Nikodemi pa diçka në jetën e Jezusit që e tërhoqi.

Ne nuk jemi Jezusi, por jemi ndjekës të tij. Njerëzit do të shikojnë diçka tek ti, diçka që ke ti dhe që ata nuk e kanë. Ata do të pyesin: “Çfarë ke ti që është ndryshe?” Dhe aty është momenti kur ti duhet të thuash diçka. Le të shikojmë një varg nga Bibla për këtë.

*Madje shenjtëroni Zotin Perëndinë në zemrat tuaja dhe jini gjithnjë gati për t’u përgjigjur në mbrojtjen tuaj kujt do që ju kërkon shpjegime për shpresën që është në ju, por me butësi e me druajtje. 1 Pjetrit 3:15*

(shënim për pastorin:  
opsionale:

*Kjo seri do jetë me life-story të ndryshme (të lidhura drejtpërdrejt me mesazhin), dua të ftoj persona që do të ndajnë momente nga jeta e tyre në lidhje me:*

**si e ka ndarë x person historinë e jetës me Jezusin te të tjerët)**

Ja disa hapa të thjeshtë sesi të tregosh historinë e jetës tënde me Jezusin:

- 1. Filloje me diçka si ishte jeta jote para se të njihje Jezusin.**
- 2. Përshkruaj si e dëgjove për Jezusin.**
- 3. Trego çfarë ndryshimi ka bërë Ai në jetën tënde.**

Para, si dëgjove dhe më pas, si ndryshoi jeta jote. Jezusi, kur vjen në jetën tënde, merret me këto tri pjesë: pastron të shkuarën, i jep kuptim të sotmes dhe siguron të ardhmen.

Kur ti zgjedh të besosh Jezusin, e sheh jetën ndryshe, flet ndryshe, jeton ndryshe, trajton të tjerët ndryshe. Je ndryshe në shkollë, ndryshe në punë. Kur Jezusi vjen në jetën tënde, e ndryshon atë sepse ti nuk vendos më shpresat në gjëra të tjera, por vetëm në Jezusin.

Sa herë që të jepet mundësia, trego për marrëdhënien që ke me Jezusin—si ai vdiq për ty që të jesh i falur dhe si fuqia e Frymës së Shenjtë është me ty çdo ditë. Jeta me Jezusin nuk është gjithmonë një fushe me lule; jeta ka sfida, POR ndryshimi është se ti nuk përballon jetën dhe sfidat e saj vetëm. Ai është aty me ty çdo ditë, çdo minutë, çdo sekondë.

### **Ji i gatshëm dhe kërko nga Perëndia të japë mundësi të reja çdo ditë.**

Nuk do ndihesh gjithmonë gati, por ji i gatshëm sa herë që del mundësia. Kërko nga Perëndia çdo ditë: "Zot, më jep mundësinë sot të flas për ty." Sidomos për njerëzit që i dëgjon, që i shërben, që pi kafe me ta. Nëse nuk ndihesh sikur duhet të flasësh, pyete veten: "Cili është meraku im më i madh? Të jem rehat unë, apo ky person të njohë Jezusin më mirë?"

Çfarë mund të jetë më e bukur për jetën e një personi sesa të njohë dashurinë e Perëndisë dhe të zgjedhë të besojë Atij, vetëm sepse dëgjoji historinë tënde dhe sesi Perëndia ka vepruar tek ti? Ti ke për ta bekuar shumë, shumë jetën e atij personi.

### **Ti zbulon misionin e jetës tënde ndërkohë që flet për Perëndinë.**

**B.E.K.O.J.** Perëndia ka për të përdorur ty për të bekuar dikë këtë javë.

*Une do të bekoj ... dhe të gjithë njerëzit e tokës do të bekohen nëpërmjet teje.*  
**Do të të bekoj që të jesh bekim.** Zanafilla 12:2-3

Lutem shumë që fokusi i jetës tënde të jetë për të bekuar dikë. Fillo me lutje, dëgjim, pirje kafe, shërbim dhe tregim të historisë së jetës tënde.

**A je gati?** Perëndia të është shfaqur ty në forma të ndryshme dhe të ka bekuar dhe do të bekojë akoma më shumë. Le të jemi bekim për dikë, le të njihemi si kishë që është bekuar dhe bekon të tjerët.

Lutemi: Kujt do t'i flasësh këtë javë për dashurinë e Perëndisë? Për cilin po lutesh, cilin po dëgjon, me cilin po pi kafe, kujt i ke shërbyer? Vendos për të treguar historinë e jetës tënde këtë javë.

### **Lutemi**

### **Lutja e Shpëtimit**

Perëndia do të të përdorë për gjëra të mëdha. E di si ndodhin gjërat e mëdha?  
Ndodhin vetëm gjëra të mëdha. Nëse ne bëjmë gjëra të vogla ditë pas dite,  
gjërat e mëdha do të ndodhin vetë.